



REPUBLIKA E KOSOVËS	1	REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS	VRHOVNI SUD KOSOVA	
G.J.A-Su.A	158/2020	
Dt:	21.08.2020	
PRISHTINË - PRIŠTINA		

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 26, paragrafi 1. Pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat, në Seancën e Përgjithshme, të mbajtur me datë 20 gusht 2020, me shumicë votash, miratoi këtë:

MENDIM JURIDIK

Vepra Penale e "Mosveprimit sipas dispozitave shëndetësore gjate epidemisë" nga neni 250 i Kodit Penal të Republikës se Kosovës, nuk mund të konsiderohet e konsumuar nga i dyshuari kur kemi te bëjmë me shkeljen e vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për masat e parapara që detyronin qytetarët.

Kjo vepër penale mund të konsiderohet e konsumuar vetëm kur kemi te bëjmë me vendime individuale që organet kompetente të autorizuara me ligj, kanë lëshuar ndaj cilidho person apo grupei personash për ndonjë masë konkrete që ai/ata të mos veprojnë.

A r s y e t i m

Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan, me parashtresën e datës 20.05.2020 ka kërkuar nga seanca e përgjithshme e Gjykatës Supreme të Kosovës, dhënien e mendimit juridik në lidhje me veprën penale të Mosveprimit sipas dispozitave shëndetësore gjatë epidemisë, e cila sanksionohet në kuadër te nenit 250 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke theksuar po ashtu se kemi një vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës 01/15 të datës 23.03.2020, me të cilin është ndaluar qarkullimi i lirë i qytetarëve

dhe automjeteve në Republikën e Kosovës nga ora 10 h - 16 h dhe 20 h- 06 h e gjithashtu në kuptim edhe të aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KO 54/20 të datës 31.03.2020.

Duke analizuar dispozitën e nenit 250, ku parasheh se: "Kushdo që gjatë kohës së epidemisë ose të ndonjë sëmundjeje ngjitëse nuk vepron sipas urdhavrave apo vendimeve tjera të nxjerra në bazë të dispozitave të organit kompetent, i cili cakton masat që kanë për qëllim luftimin apo parandalimin e tyre, dënohet me burgim deri në dy (2) vjet".

Marrë për bazë faktin se Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka shqyrtauar kushtetutshmërinë e vendimit të qeverisë, nr. 01/15 të datës 23.03.2020, dhe se me Aktgjykin nr.54/20 të datës 31.03.2020 ka konstatuar se vendimi i Qeverisë nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën e Kosovës.

Fillimisht duhet pasur parasysh se kjo vepër penale kryhet me mosveprim, në përputhje me masat e paracaktuara, që si të tilla, masat duhet të jenë të marra me "vendimin e organit kompetent", *bazuar në nenin 41 dhe 44 të Ligjit për Luftimin dhe parandalimin e Sëmundjeve Ngjitëse nr. 02/L-109 dhe neneve 12 (1.11) dhe 89 të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi*. Ndërsa sipas kërkesës së Gjykatës Themelore në Gjilan rezulton se aktakuzat e ngritura nga Prokuroria, mbështeten në mosveprimet e të dyshuarve bazuar në vendimin e lartcekur të Qeverisë.

Në rrethana të rastit konkret, të kërkesës së parashtruar, duhet të kemi parasysh dy fakte qenësore: Fillimisht se kjo dispozitë ku inkriminohet vepra penale ka natyrë blankete, pasi që udhëzon në dispozitat e ligjit nga ku merret vendimi nga organi i caktuar për masat për luftimin e epidemisë, gjë që rezulton se nuk ishte marrë nga organi kompetent e në anën tjetër nuk kemi vendim mbi centralizimin e kompetencave brenda ekzekutivit për luftimin e epidemisë përkatësisht pandemisë, e po ashtu tashmë kemi një standard kushtetues të krijuar në raport me vendimin e tillë, që është konsideruar si kundër-kushtetues, çka nënkupton se vendimi i tillë është me efekt të nulitetit absolut e kjo edhe sipas ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, ku në nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ka paraparë, se një akt administrativ është i

kundërligjshëm kur, "organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë". Në këto rrethana, konsideroj se aktin administrativ që edhe Gjykata Kushtetuese e ka konsideruar se nuk është në përputhshmëri me Kushtetutën, ne duhet ta marrim përbazë aspektin e kundërligjshmërisë së tij, vetëm për të nxjerr qëndrimin e drejtë dhe të ligjshëm, për sa i përket veprës penale, për të cilën, është kërkuar qëndrim parimor.

Njëkohësisht duhet të kemi parasysh edhe rrethanën tjetër: siç rezulton, kërkesës së parashtruar nga Gjykata Themelore në Gjilan, i është bashkangjitur një kopje e akuzës se prokurorisë, dhe nga rrethanat faktike, rezulton se kemi të bëjmë me veprimin e mos respektimit të kufizimit të lirisë së lëvizjes, sipas Vendimit të Qeverisë. Pikërisht Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka konstatuar se vendimi me të cilin është kufizuar liria e lëvizjes është në kundërshtim me Kushtetutën, ku në piken 5 të aktgjykimit, Gjykata Kushtetuese e ka shpallur të pavlefshëm vendimin e tillë të Qeverisë.

Masat ndëshkuese të karakterit penal në kontekst të mbrojtjes së shëndetit publik gjatë kohës së emergjencave shëndetësore, siç janë epidemitë mund të aplikohen vetëm kur ato masa janë rreptësisht në pajtim me ligjin dhe të nxjerra nga autoritetet përkatëse të mandatuara me ligj për nxjerrjen e tyre, në të kundërtën, zbatimi i tyre në kontekst penal, do të ishte arbitrar.

(Mendim Juridik i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur më 20 gusht 2020)